

Mesazhi i Rektorit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”

Të dashur studentë,



Prof. Dr. Agim Kukeli, Ph. D.
Rektor i Universitetit “Aleksandër Moisiu”
Durrës

Studimet te FASTIP ju japin juve shansin të fitoni njohuritë teorike duke u aftësuar praktikisht në të gjitha aspektet e degës që zgjidhni. Ndërsa të diplomuarit e tjerë duan kohë për t'u përshtatur në punë pas mbarimit të shkollës, ju këtë kohë do ta keni të fituar. Gjithashtu studimet e integruara duhet të kultivojnë te ju dëshirën dhe disiplinën për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të qenë gjithmonë të informuar me të rejat më të fundit. Keni shansin më të mirë për të përfituar nga eksperiencia e profesorëve të ftuar nga universitete të ndryshme të botës.

Ju uroj sukses në rrugën e bukur dhe plot sfida të dijes!

Sinqerisht,

Professor Dr. Agim Kukeli, Ph.D.

Në këtë numër:

Përhëndetje nga Dekani i FASTIP,
Doc. Vladimir Muka, MSc.



Fjalë përshëndetëse e
Drejtorit të Përgjithshëm të BKT Z.
Seyhan Pencapligil



Fjalë përshëndetëse e
drejtoreshës rajonale të Bankës
CREDINS Durrës, Znj. Ela Golemi



CSU Dominguez Hills

Professor Thomas Norman, Ph.D. i
ftuar nga California State Univer-
sity, dha lëndën Ekonomia Ndërkombëtare e Bankave.

Studime dhe Praktikë - Ndërkombëtare dhe Profesionale

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën - FASTIP - i hapur me VKM nr. 827, datë 11.06.2008 pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, është i pari fakultet në Shqipëri që ofron studime akademike të kombinuara me trajnimin praktik në kompani private. FASTIP është ngritur bazuar në konceptin e suksesshëm të studimeve duale, i vënë në jetë më shumë se 30 vjet më parë të njohura me emrin “Duale Hochschule”.

FASTIP ofron tre programe studimi, ku secili zgjat tre vjet:

- Menaxhim i Bankave - DNP (Bachelor Degree) - 30 studentë në vit
- Menaxhim i Hoteleri - Turizmit - DNP (Bachelor Degree) - 30 studentë në vit
- Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme - DNP (Bachelor Degree) - 30 studentë në vit

FASTIP ofron kushte mësimdhënie unike dhe të shkëlqyera:

- Grupe të vogla, ku çdo student ka kontakt të drejtpërdrejtë dhe shkëmbim eksperience me lektorin.
- Profesorë ndërkombëtarë të kualifikuar
- Teoria më e avancuar e adaptuar me kushtet e punës praktike për menaxherët e ardhshëm.

FASTIP - Alternativa më e mirë



*Doc. Vladimir Muka, MSc.,
Dekan i FASTIP*

Kryerja e shkollës së mesme është një ndërrmarje shumë e rëndësishme. Përfundimi me sukses i saj tregon se rruga e jetës ka marrë një nisje të mirë. Shkolla e mesme të jep njohuri, të bën të pjekur. Më i rëndësishëm se kaq është fakti që shkolla e mesme të bën të aftë që për të nesërmen të zgjedhësh rrugën më të mirë të mundshme.

Me cilësinë e dekanit të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën, kam kënaqësinë t'ju ftoj në fakultetin e parë të studimeve duale në vend.

Ky fakultet i ri si pjesë e universitet më të ri publik, Universitetit „Aleksandër Moisiu“ Durrës, ofron paralelisht me studimet akademike praktikën profesionale.

Gjithashtu, ju garantoj se stafi akademik dhe administrativ është tërësisht i angazhuar që të jetë pranë çdo studenti që nga momenti i pranimit deri në diplomim.

Të gjitha këto, si edhe fakti që metodologjia e punës në FASTIP është tërësisht e mbështetur në përvojën e suksesshme gjermane, më bëjnë shumë optimist. Tashmë, personalisht jam i bindur se FASTIP-i po hap rrugë të reja, se FASTIP-i është një risi e suksesshme në arsimin e lartë në Shqipëri, se studentët e përgatitur në FASTIP do të renditen shumë shpejt në top listën e specialistëve shqiptarë.

Prandaj, edhe një herë, si dekan e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën ju ftoj të bëheni pjesë integrale e FASTIP-it, ju ftoj të shfrytëzoni këtë mundësi reale dhe shumë të mirë.

Ne punojmë që FASTIP të bëhet një Histori Suksesi ...

Për mua është kënaqësi që në emër të Bankës Kombëtare Tregtare të uroj dhe të mbështes arrijtet e deritanishme të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën si një trend i ri i partneritetit publik dhe privat në edukimin universitar në Shqipëri.

Ne ndihemi të lumtur e krenarë që jemi pjesë e një iniciative pioniere që ka sjellë risi në botën e dijes dhe të punës në Shqipëri. Tani, pas afër tre vitesh mund të themi se objektivi i ndërtimit të këtij modeli është në rrugën e duhur dhe përbën hapin e sigurt në rrugën e ndërtimit të paradigmeve moderne të institucioneve akademike të lidhura fort dhe organikisht me botën e biznesit e tregun e punës.

BKT do të vazhdojë mbështetjen e grupeve të studentëve në Degën Menaxhim Bankar, duke bërë gjithçka që studimet e integruara pranë FASTIP-it, tani dhe në të ardhmen të shënojnë progres, duke e bërë atë një histori të vërtetë suksesi; një shembull për t'u ndjekur nga gjithë bizneset e tjera.

BKT vazhdon të besojë se, Shqiptarët janë vlerat më të çmuara të Shqipërisë, dhe prandaj ajo do të vazhdojë të investojë në zhvillimin e kapitalit njerëzor të vendit.

Suksese të mëtejshme!

Partneriteti me FASTIP, sukses i garantuar

Ne, Banka CREDINS ndihemi shumë të kënaqur, që për të dytin vit rradhazi jemi partner dhe mbështesim një projekt risi dhe nevojën në fushën e edukimit në Shqipëri. Ne jemi të sigurtë se ky model dual i studimit dhe praktikës do të rrisë shanset për t'u përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe të biznesit për t'u integruar në një ekonomi globale, ku rol të rëndësishëm luajnë specializimet dhe gjuhët e huaja.

Nën asistencën profesionale të partnerëve gjermanë, FASTIP ka vendosur standarde evropiane të studimit dhe praktikës duke i hapur rrugën një procesi, i cili do të çojë përpara arsimin profesional në Shqipëri, si nevojë dhe domosdoshmëri e tregut. FASTIP përbën një zhvillim pozitiv, një model për t'u ndjekur me qëllim mbështetjen e një tregu pune, i cili funksionon bazuar në kriteret dhe kërkesat e ekonomisë së tregut.

Në rolin e mbështetësit praktik të studentit, ne investojmë të dëshmojmë shkollim adekuat, që konsiston në përcjelljen e profesionit dhe praktikës tek studentët me kriteret pedagogjike.

I urojmë suksese FASTIP në sfidën e tij të zgjerimit në degët e reja, Hoteleri-Turizmit dhe NVM-ve, duke i dhënë mbështetjen dhe partneritetin tonë pa rezerva.



*Dr. Seyhan Pencapligil, Drejtor
i përgjithshëm i BKT-së*



*Ela Golemi, Banka CREDINS
Drejtoreshë Rajoni, Durrës*

Të punosh si Përgjegjës Departamenti në FASTIP



Dorian Kristiqi, MA, Përgjegjës i Departamentit të Menaxhimit të Bankave

Dorian Kristiqi është në pozicionin e Përgjegjës të Departamentit të Menaxhimit të Bankave që nga Marsi 2009. Ai ka kryer studimet e larta dhe ato master në Ekonomiks dhe Menaxhim Banke në Universitetin e Leipzig, Gjermani. Momentalisht është në vazhdim të doktoraturës në shkencat ekonomike pranë Universitetit „Aleksander Moisiu“ Durrës.

Si Përgjegjës departamenti disa nga detyrat e tij kryesore janë: mbarëvajtja e procesit mësimor, zhvillimi dhe adaptimi i kurrikulave, përzgjedhja e kontakteve dhe kontakti me profesorët e huaj me qëllim ardhjen e tyre për të dhënë mësim në FASTIP.

Një përgjegjësi tjetër e tij është dhe mbarëvajtja e partneritetit me kompanitë bashkëpunuese dhe ndjekja e progresit të studentëve në vazhdimësi.

Ja si e përshkruan Z. Kristiqi eksperiencën e tij të deritanishme:

Profesorët e huaj: Para se të vendosin të vijnë në Shqipëri ata duan të dinë shumë detaje. Duket se ata nuk dinë shumë për këtë vend! Por sapo mbërrinin ndryshojnë mendim. Pjesa më e madhe e tyre janë të kënaqur që janë këtu dhe shprehin dëshirën të vijnë përsëri. Ata madje ua rekomandojnë programin FASTIP dhe kolegëve të tyre në raste kur na nevojiten profesorë të rinj. Atyre u pëlqen të japin mësim për grupe të vogla me studentë të interesuar për lëndën. Si përgjegjës departamenti është shumë e rëndësishme njohja shumë e mirë si e realitetit shqiptar ashtu dhe atij ndërkombëtar. Shpesh lind nevoja që t'u shpjegosh njerëzve të ndryshëm, studentëve si dhe profesorëve aspekte të ndryshme kulturore të shoqërisë përkatëse.

Bankat: Bashkëpunimi me dy bankat partnere të deritanishme, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Credins është shumë i mirë. Në fillim të programit, si FASTIP ashtu dhe bankat partnere duhet të ishim shumë fleksibël pasi ishte diçka e re për të dyja palët. Gjatë semestrit të parë të praktikës punuam për gjetjen e zgjidhjeve praktike dhe tani jemi në rrugë të mbarë në konsolidimin e praktikave mësimore. Punonjësve të bankave u pëlqen të punojnë me studentët tanë; ata vlerësojnë idetë dhe metodat e reja që sjellin studentët. Ne në FASTIP na gëzon shumë ky fakt dhe na bën të kuptojmë konfirmimin e modelit dual nga partnerët pjesëmarrës.

Studentët: Ne punojmë shumë që studentët tanë të kuptojnë vlerën e asaj që marrin nga FASTIP. Ata janë më pak se 30 studentë në klasë dhe kanë fatin më të mirë që të konsultohen direkt me profesorin duke e pasur atë në dispozicion të tyre çdo ditë nga ora 9 deri në 16. Ky është një shans që nuk e ka asnjë student në fakultetet e tjera publike. Gjithashtu në fazën praktike ata ndiqen dhe orientohen nga personat përgjegjës në banka me të cilët fakulteti mban kontakte të vazhdueshme mbi ecurinë e studentëve dhe në fazën e praktikës.

Këndi i studentëve



Bledar Topi, Student, BKT

“Më ngacmuese për mua në fillim ishte pjesa praktike. Nuk kam punuar më parë në bankë. Kur shkuam për praktikë u pritëm shumë mirë. Pas kryerjes së fazës së parë të praktikës në degët e BKT në Durrës m'u ofrua që fazat e tjera të praktikës t'i kryej në zyrat qendrore të BKT në Tiranë pranë departamentit të Kredive. Afërsisht 70% të asaj që mësojmë në klasë gjatë teorisë mund ta aplikojmë në praktikë. Nga profesorët shqiptarë marrim shumë informacione të rëndësishme rreth specifikave të tregut vendas ndërsa ata ndërkombëtarë sjellin pikëpamje të ndryshme dhe metodat më të reja.”



Geis Barçi, Studente, BKT

“FASTIP është vërtetë unik në Shqipëri sepse asnjëherë më parë teoria dhe praktika nuk janë kombinuar në këtë mënyrë... Dhe kjo ka qenë shumë motivuese për të gjithë klasën. Gjatë praktikës shohim vlerat e këtij kombinimi, madje ne përçojmë dhe ide të reja te kolegët tanë në bankë. Me gjithë sa thashë më sipër ky lloj programi është shumë intensiv dhe kërkues, por duke qenë ndryshe nga universitetet e tjera tradicionale në Shqipëri në emër të të gjithë studentëve të kursit Menaxhim i Bankave mund të them me bindje që çdo gjë vlen!”

Perspektiva Ndërkombëtare



Thomas Norman, Ph.D., Lektor i ftuar

“Programi i FASTIP është i ri për mua por duke qenë se kam qenë pjesë e projekteve ndërkombëtare di se si punojnë gjermanët; ky program studimi është shumë i ngjashëm me ato gjermane. Nga eksperiencia ime 15 vjeçare në biznes, transferimi i njohurive sipas këtij sistemi është më i miri - ajo që ti mëson mund të vihet në jetë gjatë 3 muajve të praktikës në çdo semestër dhe ndërkohë të bësh një punë shumë të mirë, kështu që mendoj se ka shumë avantazhe.

Kjo është hera e parë që unë vij në Shqipëri dhe është shumë pozitive, e mrekullueshme, shumë më moderne nga ç'e prisja. Shoh që Shqipëria ka shumë mundësi. Disa nga kolegët e mi kanë qenë këtu, dhe kisha dëgjuar që FASTIP-i ishte një program shumë i mirë, me studentë shumë të zgjuar dhe pashë që të gjitha këto ishin të vërteta. Tre nga kolegët e mi kanë qenë më parë këtu dhe ata kanë përshtypjet më të mira për programin e studimeve duale që aplikohet këtu në FASTIP.”

Në Rrugën drejt Suksesit

Në zbatim të rojektit "Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet arsimit profesional në Shqipëri" dhe marrëveshjes së MASH me Qeverinë gjermane dhe GTZ, nën ombrellën e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, por me statut autonom, në tetor 2008 u çel Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën.

Faza e parë e mbështetjes gjermane u realizua nga zyra e projektit ABU Consult.

Në prill 2010 nisi faza e dytë e mbështetjes gjermane për FASTIP. Në emër të Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit mbH (GTZ) - Bashkëpunimit Teknik Gjerman, kjo mbështetje do të ofrohet nga GOPA Consultants, një nga firmat konsulente kryesuese gjermane dhe një nga grupet më të fuqishme këshilluese në Evropë. Qysh nga viti 1965, GOPA Consultants ka zbatuar me sukses mbi 3,000 projekte manaxhimi dhe trajnimi për agjencitë financuese kombëtare dhe ndërkombëtare në më shumë se 130 vende të botës.

Bazuar në një ekspertizë të gjerë dhe të sprovuar globale në çështje të zhvillimit si dhe në mundësinë për të punuar me një rrjet specialistësh ndërkombëtarë të kualifikuar nga e gjithë bota, mbështetja e GOPA Consultants për FASTIP-in mendohet të mbulojë katër fusha të ndërlidhura:

1. Manaxhimi i ekspertizës gjermane për FASTIP-in
2. Mbështetja për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënies si dhe të manaxhimit akademik në FASTIP.
3. Mbështetje për fuqizimin e bashkëpunimit të FASTIP me kompanitë, organizatat ekonomike, donatorët ndërkombëtarë si dhe institucionet akademike partnere në Gjermani.
4. Përhapja e modelit dual të studimit në universitetet e tjera në Shqipëri.

Gjatë katër muajve të parë, kemi punuar në këto fusha:

1. Është hapur zyra me një staf të kualifikuar.
2. U hartua dhe u diskutua Plani i Përgjithshëm i Veprimtarive në seminarin e inagurimit me partnerët e biznesit dhe përfaqësuesit nga institucionet publike.

3. U kryen dy studime empirike për nevojat e kompanive lidhur me degët e reja të studimit në FASTIP. Këto studime çuan në hartimin e dy kurrikulave modulare dhe planit të studimeve bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve.
4. Stafi i GOPA Consultants dhe ekspertët e saj kanë mbështetur FASTIP me organizimin e disa takimeve me bizneset potenciale Shqiptare me qëllim rekrutimin e studentëve për programet e reja si dhe në hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Shoqatën Shqiptare të Turizmit, ATA.
5. Ekspertët tanë kanë dhënë propozime për përmirësimin e strategjisë së marketingut në FASTIP dhe në hartimin e instrumenteve dhe produkteve të nevojshme promovuese të FASTIP.



Dr. Hans-Günther Wagner (Udhëheqës ekipi),
Eriola Shingjergji (Zv/udhëheqëse ekipi),
Albana Jorgo (menaxhere zyre)

Opinione të ekspertëve të ftuar nga GOPA mbi perspektivat e FASTIP-it



Günther Heiduk,
Ekspert

"FASTIP-i duhet të përpiqet të zhvillojë strukturën institucionale në mënyrë që të lejojë një rrugë menaxhimi më fleksibël.

Implementimi i suksesshëm i këtij koncepti inovativ - teoria e integruar me praktikën - kërkon aftësi të mëdha menaxheriale që të jetë në të njëjtin nivel me standartet ndërkombëtare. FASTIP-i ka gjitha shanset për këtë nëse ndjek hapat e duhur."



Herman Sonneveld,
Ekspert

"Kemi vizituar mbi 40 kompani dhe pamë që ka një interes të madh për FASTIP-in, veçanërisht në kurrikulat që ofron fakulteti. Mendoj që është shuëi rëndësishëm fakti që FASTIP-i të theksojë qartë pikat e tij të forta: lidhjen direkte të programit mësimor me nevojat e kompanive. Por gjithashtu FASTIP-i duhet t'i përgjigjet me fleksibilitet dhe nevojave të ndryshme të kompanive si psh. përshtatja e orarit të fillimit të mësimit për sezona të veçanta të vitit. Nëse FASTIP-i do të arrijë të implementojë programin me një fleksibilitet të tillë, kjo mund të rezultojë shumë e suksesshme."

Buletini Informativ i FASTIP përmbledh informacionet më të rëndësishme si dhe mendime e përshtypje rreth fakultetit.

Ky Buletin Informativ del çdo tre muaj.

Përgatiti: Anduela Kaja

Redaktoi: Denata Nuellari

Kontakte:

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

Lagjja 17 Rruga "Adria" Durrës-Shqipëri

Tel+Fax: +355-52-22 44 16

Email: info@fastip.edu.al

Web: www.fastip.edu.al